



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

I nderuar ministër Besimi,

Në zgjedhjet parlamentare të cilat u mbajtën më 15 korrik të vitit 2020, qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjodhën që të vazhdojmë ta dërgojmë shtetin përpara. Vota e qytetarëve për koalicionin që ka formuar Qeverinë e re me mandat prej vitit 2020 deri në vitin 2024 është investimi i tyre vetanak në kërkim të jetës më të mirë për vete, për familjet dhe bashkësinë e tyre. Vota e secilit qytetar është votë për mbrojtje nga KOVID-19 dhe për menaxhim të suksesshëm me krizën ekonomike-shëndetësore, votë për ekonominë e re vendore, për vende të reja të punës të paguara mirë, për shtet të së drejtës, për mjedis jetësor të pastër dhe të shëndetshëm, për infrastrukturë funksionale, për lidhje efektive brenda vendit dhe me botën, për kulturë të fuqishme nacionale sipas modelit evropian dhe arsim që i përgatit gjeneratat e reja për të tashmen dhe një të ardhme më të mirë.

Në kuptimin burimor të fjalës „ministër“ gjendet shërbimi, kujdesi dhe ndihma për qytetarët. Ju, si ministër, duhet ta kuptoni votën e qytetarit si drejtim i precizuar që vjen nga niveli më i lartë nga i cili nuk ka asnjë devijim. Duhet t'u shërbeni të gjithë qytetarëve, pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, partiake, orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor, racor, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë në grupe të marginalizuara, gjuhës, statusit social, shkollimit, religjionit, bindjet politike, bindjet tjera, aftësive të kufizuara, moshës, statusit familjar apo martesor, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, statusit personal dhe statusit shoqëror. Pres që për kryerjen e detyrave tuaja dhe në realizimin e Programit për punë të Qeverisë për vitet 2020-2024, do të angazhoheni pa hezitim dhe me profesionalizëm. Kemi detyrim të shenjtë dhe thelbësor që agjendën për të cilën obligohemi para qytetarëve ta realizojmë duke investuar përpjekjet tona maksimale, përmes realizimit efektiv për arritje të rezultateve më të mira të mundshme. Kjo mënyrë nuk njeh kompromise, justifikime dhe përfshin ekspozim të vazhdueshëm para opinionit publik ku do t'i vëmë në dispozicion të gjithë mekanizmat për të ndjekur punën tonë.

Ju jeni pjesë e Qeverisë e cila hapur e prezanton punën e saj dhe është e hapur për secilin qytetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Unë, si Kryetar i Qeverisë do ta avancoj strukturën e kabinetit tim me qëllim që të jem Kryeministër më i hapur dhe të siguroj komunikim të dyanshëm me të gjithë qytetarët dhe bashkësitë të cilëve ju duhet ndihmë nga unë dhe shërbimet e mia, por edhe të kem mundësi që t'i pranoj dhe t'i kuptoj të gjitha idetë dhe iniciativat që vijnë nga opinioni publik. Ju obligoj edhe juve për komunikim të rregullt dhe të hapur me të gjithë qytetarët dhe palët e interesit në shoqëri duke avancuar kanalet për përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje.

Puna e juaj çdo ditë do të ndiqet dhe matet. Nëse jeni të përkushtuar, të ndershëm dhe të përgjegjshëm do të keni rezultate të shkëlqyeshme dhe do të vazhdoni të punoni edhe më mirë për më shumë rezultate. Në të kundërtën, do të zëvendësoheni me kuadër tjetër i cili është i gatshëm të jep angazhim më të mirë dhe më të sinqertë se sa Ju. Vetëm kështu është e drejtë dhe e ndershme para

Letër mandati për ministrin e financave
3 shtator 2020



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

fjalës që ua kemi dhënë qytetarëve. Për atë, konkluzionet e para nga puna juaj do t'i sjell pas përfundimit të 100 ditëve të para të mandatit, gjegjësisht në përfundim të vitit 2020, pas të cilit janë të mundshme ndryshime kadrovike. Analizën metodologjike të realizimit të detyrave dhe punës suaj të përgjithshme do ta bëjmë çdo fundvit.

Duke ju nominuar juve për ministër në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, isha i bindur se mund të llogaris në përgjegjësinë dhe përkushtimin tuaj të plotë në kryerjen e detyrave. Pikërisht për këtë, pres rezultate të menjëhershme. Qytetarët kanë pritje, ndërsa Ju jeni në pozicion që të bëni gjithçka që është e nevojshme që Qeveria të realizojë pritjet e qytetarëve.

Kriza e shkaktuar nga KOVID-19 fuqishëm e goditi ekonominë e vendit edhe atë botërore. Qëllimi jonë nuk që Qeveria të jetë vetëm menaxhues i suksesshëm në krizën, por në mënyrë më të shpejtë ta tejkalojmë krizën dhe të kthehemi në rrugën e rritjes dhe zhvillimit, të zbatimit të politikave thelbësore dhe për kohë sa më të shkurtër të përgatitemi për "normalitetin e ri" pas KOVID-19. Ta trasojmë rrugën evropiane me politika reformuese dhe rritje të përshpejtuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme me qëllim që në afat të mesëm kohor ta përmirësojmë standardin dhe kualitetin e jetesës së qytetarëve dhe të arrijmë nivelin e qytetarëve të Bashkimit Evropian.

Nga Ju, si ministër i financave, pres që të angazhoheni në realizimin e qëllimeve të përcaktuara nga Qeveria – të menaxhoni me financat publike në mënyrë e cila do të mundësojë transformim të ekonomisë tonë me qëllim që ajo të jetë më konkurruese brenda dhe jashtë vendit. Lëvizja e ekonomisë do të jetë e bazuar në valë të fuqishme të investimeve publike, investime të drejtpërdrejta vendore dhe të huaja dhe në inovacione në të gjithë sektorët. Investimet kapitale të jenë gjenerator i shpenzimeve të investimeve publike që në tërësi të fokusohemi në potencialin e madh të konsumit vendor dhe investimeve.

Më konkretisht, pres nga Ju:

- Deri në fund të mandatit ta ktheni ekonominë tonë në rritje solide dhe të qëndrueshme prej 4%. Pas përfundimit të krizës, të mundësoni rritje të pagës minimale deri në fund të mandatit në lartësi prej 20 deri në 40% dhe rritje të pagës mesatare deri në fund të mandatit prej 20 deri në 30%, në varësi prej zgjatjes dhe ndikimit të epidemisë ndaj ekonomisë së vendit dhe asaj botërore;
- Gjatë krizës ta mbani stabile shkallën e papunësisë, ndërsa pas përfundimit të krizës dhe deri në fund të mandatit të vazhdojmë ta zvogëlojmë papunësinë në nivel vjetor prej 3%;
- Të siguron investime të huaja në vlerë prej së paku 1 miliard euro për 4 vite, duke u fokusuar në investime të bazuara në inovacione, shkallë të lartë të finalizimit të prodhimeve dhe shërbimeve dhe qëndrueshmëri të bizneseve;

Letër mandati për ministrin e financave
3 shtator 2020



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

- Në bashkëpunim me Qeverinë të përgatisni kornizë ligjore dhe financiare me të cilën niveli i investimeve publike do të rritet në 2,2 miliardë euro përderisa investimet e pritshme private të jenë 1,2 miliard euro gjatë gjithë mandatit;
- Përmes njësisë për ndjekje në Ministri dhe njësisë qendrore për mbështetje të investimeve publike në nivel qeveritar, të koordinoni procesin për rikonfigurim të plotë të procedurave dhe sistemit për realizimin e investimeve publike kapitale;
- Bashkë me Qeverinë të filloni me etapa zbatimin e financimit buxhetor sipas principit të përmbushjes së indikatorëve zhvillmor (smart Key Performance Indicators) në secilin sektor;
- Të siguroni mbështetje direkte për investimet vendore dhe të huaja në vlerë prej 300 milionë euro nga buxhetet vendore dhe alokim direkt të 300 milionë eurove të pritura nga fondet evropiane;
- Të realizoni mbështetje direkte për kompanitë vendore përmes Planit për rritje ekonomike dhe Ligjit për mbështetje financiare të investimeve me financim të avancuar të nevojave teknologjike dhe inovative të eksportit në lartësi prej 10% deri në 15% të investimit të projektuar;
- Në bashkëpunim me Qeverinë të rritni vëllimin e mbështetjes financiare për kompanitë vendore përmes Planit për rritje ekonomike për 25% çdo vit në krahasim me vitin paraprak;
- Të përgatitni analizë për liberalizim gradual të politikave investuese të fondeve pensionale private në shtyllës së dytë dhe të tretë të sigurimit pensional të financuar në mënyrë kapitale;
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë të formoni fond të veçantë si nxitje për hyrje në fondet investuese të huaja;
- Të garantoni parashikueshmëri në politikën tatimore. Tatimi i fitimit të mbetet në nivelin e 10% gjatë gjithë periudhës deri në vitin 2024, ndërsa të parashikoni lirim nga ky tatim gjatë riinvestimit të fitimit në vitin 2021 si përgjigje nga ndikimi i efektit nga pandemia KOVID-19;
- Tatimi personal i të ardhurave të ulet në 0% në vitin 2023 për industrinë IT edhe atë gradualisht: 5% në 2021, 3% në 2022 dhe 0% në 2023. Tatimi i të ardhurave personale të mbetet 10%, por përmes procesit gjithëpërfshirës të negociatave dhe krijimit të konsensusit të implementohet në mënyrë progresive;
- Ta rikonfiguroni TVSH-në përmes një sërë masash, duke filluar me Ligj të ri për TVSH-në që do të mundësojë përfitime tatimore për ndërmarrjet e orientuara në eksport; shkallë të vetme prej 10% TVSH për gjitha shërbimet në restorante, rishikim të shkallës së TVSH-së për lëndët e para për prodhuesit vendor dhe ulje të shkallës së TVSH-së për prodhuesit në bujqësi, ulje të shkallës së TVSH-së për lëndët e para për kompanitë e orientuara në eksport, ulje prej 18 në 5% të shërbimeve artizanale, ngritje e pragut për pagesë të TVSH-së nga 2 në 3 milionë denarë të qarkullimit vjetor nga 01.01.2022 dhe barazim me pragun për lirim nga tatimi për fitim deri në 3 milionë denarë të qarkullimit vjetor;



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

- Të vazhdoni me realizimin e suksesshëm të masës “TVSH-ja ime”, si dhe kthimin e TVSH-së në kohë, në mënyrë të rregullt dhe joselektive për personat juridik;
- Të përgatisni dhe t’i propozoni Qeverisë Ligj të ri për tarifën doganore dhe përshtatje të përshtatshme;
- Të mundësohet mbështetje më e madhe për kompanitë dhe sektorët e vendit, përmes krijimit të ambientit për biznes dinamik dhe konkurrues, i çliruar nga ndikimet politike, zvogëlim të procedurave dhe barrierave administrative, ndërsa me shfrytëzim të plotë të frymës sipërmarrëse dhe njohurive të kapitalit njerëzor vendas;
- Të hiqni tatimin mbi të ardhurat personale për kategorinë e trajnimit, kualifikimeve, marrjen e licencave që mundësojnë përmirësimin e kualitetit të fuqisë punëtore me të cilat disponojnë kompanitë;
- Ta filloni procesin e uljes së detyrimeve parafiskale deri në 75% dhe nivelin e tyre në përputhje me madhësinë e subjekteve ekonomike përmes dialogut me odat ekonomike;
- Të implementoni listën e bardhë të tatimpaguesve, gjegjësisht të kompanive që rregullisht i paguajnë obligimet e tyre tatimore. Në Ligjin për disiplinë financiare t’i kyçni edhe institucionet shtetërore dhe qeveritare dhe do t’i barazoni me detyrimet e sektorit privat;
- Të përgatisni dhe t’i propozoni Qeverisë Ligj të ri për e-tregtinë në funksion të rregullimit të e-biznesit dhe largimin e konkurrencës jo-lojale dhe evazionit tatimor;
- Në bashkëpunim me Qeverinë të filloni procesin e dekapitalizim të Bankës zhvillimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të mundësoni instrumente të qarta, efektive dhe të matshme për financimin e nevojave të kompanive eksportuese, gjegjësisht financim direkt të eksportit dhe rritje të vëllimit të tij dhe konkurrencës së produkteve dhe shërbimeve vendore;
- Në bashkëpunim me Qeverinë të vazhdoni të krijoni dhe realizoni masa për mbështetje të qytetarëve dhe ekonomisë në luftën me pasojat nga kriza e KOVID-19:
 - Të mundësoni masa sociale të shpejta dhe të fuqishme për më shumë qytetarë dhe familje;
 - T’u ndihmoni ndërmarrjeve në periudhat e vështira përmes mbështetjes së drejtpërdrejt, garancive dhe kredive të volitshme;
 - Të lehtësohet goditja e madhe e krizës ndaj kompanive dhe familjeve përmes riprogramimit dhe prolongimit të pagesës së kredive;
 - Ta forconi konsumin privat me masa të orientuara ndaj familjeve të rrezikuara, të papunësuarit, të rinjtë dhe studentët.
- Të zbatoni edhe aktivitete të tjera në përputhje me zotimet dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020 - 2024.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

Njëkohësisht, si ministër i financave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Ju pres:

- Të jeni gardiani i parë i Kushtetutës dhe ligjeve dhe të siguroni që Ministria e Financave të përmbush të gjitha detyrimet ligjore, që të gjithë bartësit e funksioneve publike dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj të jenë njësoj të përgjegjshëm ndaj ligjit dhe Kushtetutës dhe se Kushtetuta dhe ligjet do të zbatohen njëjtë për të gjithë;
- Të jeni shembull i qeverisjes së mirë dhe të siguroni që zyrtarët publik dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj t'u përmbahen standardeve më të larta të qeverisjes së përgjegjshme dhe etike;
- Të siguroni që Ministria e Financave të përgjigjet në kohë, në mënyrë të drejtë, efikase dhe efektive të zgjidh çështjet dhe procedurat e qytetarëve dhe personave juridik, duke justifikuar dhe fituar besimin e qytetarëve dhe të opinionit publik;
- Të vazhdoni zbatimin dhe përmirësimin e politikave të transparencës dhe llogaridhënies;
- Të jeni i hapur dhe gjithëpërfshirës ndaj qytetarëve, publikut profesional, shoqërisë civile dhe opozitës në krijimin dhe zbatimin e politikave publike në mënyrë që të siguroni politika cilësore të bazuara në prova dhe konsensus të shoqërisë;
- Të siguroni që burimet shtetërore të mos përdoren për qëllime partiake dhe zgjedhore dhe që zyrtarët administrativ dhe punonjësit e sektorit publik të mos jenë subjekt i ndikimit partiak;
- Të promovoni barazinë gjinore dhe përfaqësimin e drejtë dhe të keni parasysh karakterin multietnik të vendit.

Bashkëpunoni me të gjithë punonjësit dhe përdorni të gjitha potencialet e administratës publike. Në të gjitha veprimet tuaja, të jeni shembull për ata me të cilët punoni dhe për qytetarët për të cilët punoni. Respektoni Kodin etik për anëtarët e Qeverisë dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria dhe promovoni vlerat etike. Në fund të mandatit tonë në vitin 2024, si rezultat i ndryshimeve pozitive që ne do të bëjmë, Maqedonia e Veriut të jetë vend ku qytetarët duan të jetojnë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e saj të vazhdueshëm. Qytetarët e presin këtë nga ne.

Ju uroj fat, shëndet dhe mandat të suksesshëm.

Sinqerisht i juaji,
Zoran ZAEV



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

Ministër i financave i Republikës së Maqedonisë së Veriut
Fatmir BESIMI